




Propozim për krijimin e
Parkut Kombëtar të Lumit të Egër të Vjosës



EcoAlbania

Shkurt 2021

Table of Contents

<u>LUGINA E VJOSËS.....</u>	3
<u>KONTEKSTI LIGJOR DHE SEKTORIAL PËR KRIJIMIN E PARKUT KOMBËTAR TË LUMIT TË EGËR TË VJOSËS.....</u>	5
HAPA TË RËNDËSISHËM TË PROCESIT TË KRIJIMIT TË ZONËS SË MBROJTUR.	5
<u>GJEOLGJIA, GJEOMORFOLOGJIA DHE HIDROMORFOLOGJIA</u>	7
GJEOLGJIA	7
HABITATET/EKOSISTEMET	7
SPECIES.....	8
TRASHËGIMIA DHE VLERAT KULTURORE TË ZONËS	9
<u>PËRKUFIZIMI I QËLLIMIT TË MBROJTJES DHE OBJEKTIVAT E MBROJTJES.....</u>	11
STATUSI I ZONËS SË MBROJTUR TË PROPOZUAR DHE ARSYETIMI I KATEGORISË SË ZONËS SË MBROJTUR NË PËRPTHJE ME STANDARDET	11
SIPËRFAQJA E PARKUT TË PROPOZUAR KOMBËTAR	11
OBJEKTIVI KRYESOR I MENAXHIMIT (MBROJTJA E EKOSISTEMEVE DHE E SPECIEVE DHE PROMOVIMI I EDUKIMIT DHE REKREACIONIT).....	11

Lugina e Vjosës

Lumi Aoos-Vjosa shtrihet 272 km nga burimi i tij në Greqi, përmes Shqipërisë së Jugut deri në Detin Adriatik. 80 kilometrat e parë të lumit janë në Greqi. Sipërfaqja totale e mbulimit është 6704 km², nga të cilat 4365 km² janë në territorin e Shqipërisë.

Në kontekstin gjeologjik, hidromorfologjik, hidrologjik dhe ekologjik, lugina e lumit Vjosa mund të ndahet në tre njësi gjeografike:

- **Seksioni i sipërm** i lumit Vjosa karakterizohet nga një varg grykash të pjerrëta mes Përmetit, Këlcyrës dhe Dragotit, të përshkuara nga zona me kone depozitimi dhe ujdhesa të mëdha. Lugina e lumit Vjosa zgjerohet në rrjedhën e sipërme të zonës së Dragotit, me përjashtim të grykave të Poçemit.
- **Seksioni i mesëm** - para dhe pas bashkë-derdhjes me lumin Drino, ku gjendet qyteti i Tepelenës, njihet për brigjet e mëdha me rërë dhe zhavorr të formuara nga lumi i degëzuar. Në rrjedhën e poshtme të Selenicës, pellgu ujëmbledhës i lumit zvogëlohet, lugina zgjerohet dhe lumi nis të gjarpërojë. Lymoret e lumit Vjosa njihen si një nga ekosistemet më të mrekullueshme bregdetare të Gadishullit të Ballkanit, të karakterizuara nga proceset e tyre natyrale hidromorfodinamike lumore. Rrjedha e gjerë e degëzuar, brigjet e mëdha me zhavorr dhe ishuj, speciet bimore pioniere, shelgjet, plepat dhe tamarisku i japin luginës së Vjosës një karakter të jashtëzakonshëm.
- **Seksioni i poshtëm** karakterizohet nga shtrirja e lumit të Vjosës dhe nga formimi i gjarpërimeve të gjera. Mes qyteteve të Fierit dhe Vlorës, lumi i Vjosës kalon mospërmasë ultësirave të Myzeqesë dhe rrjedh drejt detit Adriatik. Delta e lumit të Vjosës gjendet në veri të Lagunës së Nartës, aty ku ai arrin detin.




Figura 1: Sipërfaqja e mbulimit e Lumit Vjosa

Vjosa nuk është thjesht një nga shumë lumenjtë e njëjtë në Shqipëri. Biodiversiteti i lumit është shumë i pasur dhe plotësohet nga vlera e jashtëzakonshme e regjimit tejet origjinal të ujit përgjatë të gjithë lumit nga ku dhe nënvizohet rëndësia e Lumit të Vjosës si ekositemi i fundit lumor i degëzuar dhe i paprekur në nivel evropian.

Vjosa dhe degët e saj formojnë një ekosistem funksionues natyror mjaftueshëm të madh për zbutjen e çrregullsive të jashtme të zonave të tjera të ndryshuara që gjenden ngjitur me korridorin e lumit dhe përgjatë tij, pa cenuar ndjeshëm proceset natyrore hidrologjike. Megjithatë, ekosistemi është jashtëzakonisht i brishtë dhe i ndjeshëm, ndaj dhe mund të ndryshohet dramatikisht nga çfarëdolloj ndryshimi që mund t'i bëhet regjimit të ujit në rrjedhën e sipërme apo të poshtme.

Standardet ndërkombëtare për zonat e mbrojtura të transpozuar në legjislacionin shqiptar rekomandojnë shpalljen si zonë të mbrojtur Kategoria II “Park Kombëtar”, sipas Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN), ato zona, biodiversiteti i të cilave është ruajtur dhe që karakterizohen në mënyrë dërrmuese nga procese të pandryshuara ekologjike.



I. BAZA LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE PËR KRIJIMIN E PARKUT KOMBËTAR

Konteksti ligjor dhe sektorial për krijimin e Parkut Kombëtar të Lumit të Egër të Vjosës

Ligji "Për Zonat e Mbrojtura 81/2017" (në vijim referuar si: "Ligji 81/2017") ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike. Neni 16 i Ligjit 81/2017 përshkruan Parkun Kombëtar (kategoria II); ai përcakton se Park Kombëtar mund të shpallen: » *»territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ruben dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, për edukim dhe rekreacion (çlodhje e argëtim), që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore.«*

Planifikimi, koordinimi dhe menaxhimi i krijimit të sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura përcaktohet në "Politikat strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit 2016 - 2020" (në vijim referuar si: »Planik«).

Hapa të rëndësishëm të procesit të krijimit të zonës së mbrojtur.

Sipas Ligjit 81/2017, çdo organ e institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jofitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura (në vijim referuar si: "Ministria").

Procedura për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohet në Nenin 12 të Ligjit 81/2017 dhe përfshin hapat e mëposhtëm:

- Përfshirjen e zonës së propozuar për shpallje si Park Kombëtar në Plan.
- Projekt-deklarimin e një zone të mbrojtur mjedisore ku përcaktohen paraprakisht, statusi i saj, kufijtë dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës.
- Publikimin e planit për shpalljen e zonave të mbrojtura në nivel ministror dhe bashkiak.
- Konsultimin publik mes palëve të interesit mbi planin e shpalljes (bashkia ku gjendet zona e propozuar e mbrojtur, shoqëria civile dhe pronarët e tokave që do të përfshihen në zonën e mbrojtur) dhe paraqitjen e komenteve të planit pranë Ministrisë.
- Miratimin e shpalljes së zonës së mbrojtur nga Këshilli i ministrave.
- Miratimin e dekretit të shpalljes së zonës së mbrojtur Ministri.

Konteksti i planifikimit hapësinor

Planifikimi hapësinor dhe territorial drejtohet nga Ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit. Plani kryesor sa i përket instrumenteve të planifikimit hapësinor në nivel kombëtar është Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK), i cili mbështetet nga planet sektoriale dhe planet e detajuara të zonave me rëndësi kombëtare. PPK-ja mbështet dhe fuqizon rëndësinë e zonave me interes kombëtar, duke i zgjeruar zonat e deklaruara me qëllim mbrojtjen e tyre, por propozon edhe zona të tjera që duhet të mbrohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacion. PPK-ja e ka identifikuar krijimin e Parkut të Vjosës si korridorin e ri të mundshëm të gjelbër.

Dokumenti kryesor në nivelin vendor është Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV). Në Luginën e Vjosës, bashkitë Përmet, Këlcyrë, Gjirokastrë dhe Vlorë i kanë miratuar PPV-të e tyre, ndërkohë janë në proces finalizimi PPV-të e bashkive të Tepelenës, Memaliajt dhe Selenicës. Në PPV-të e miratuara, fuqizohet ideja e luginës së Vjosës si zonë e mbrojtur dhe si qendër e fuqishme e mundshme turistike.

Konteksti sektorial

»Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2016 – 2020« parashikon zgjerimin e sistemit të zonave të mbrojtura duke rritur sipërfaqen e zonave të mbrojtura. Në bazë të rivlerësimit të zonave të mbrojtura të bërë nga AKZM-ja në dhjetor të vitit 2019, Vjosa nuk ishte propozuar si zonë e re e ardhshme e mbrojtur në integritetin e saj të plotë. Megjithatë, disa ekspertë dhe dokumente tregojnë se në rivlerësimin e bërë nuk janë marrë saktësisht në konsideratë të gjitha vlerat e jashtëzakonshme dhe rëndësia e ruajtjes së Luginës së Vjosës.

Ekzistojnë disa dokumente të rëndësishme sektoriale strategjike që ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të Luginës së Vjosës. Ato janë: »Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2017-2027«, »Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023« dhe »Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030«.

Disa prej dokumenteve të mësipërme strategjike mbështesin mbrojtjen dhe zhvillimin e propozuar të Luginës së Vjosës, në bazë të disa formave të gjelbra turizmi; për shembull edhe PPV-të e shohin Lumin e Vjosës si korridor dhe qendër kryesore për zhvillimin të turizmit dhe të ekonomisë së komuniteteve të tyre. Megjithatë, Strategjia Kombëtare e Energjisë e konsideron lumin e Vjosës si shtyllën kyçe të diversifikimit të energjisë, gjë e cila kërcënon biodiversitetin dhe vlerat e peizazhit të lumit.

II. PËRSHKRIMI I VLERAVE NATYRORE, SOCIO-EKONOMIKE DHE KULTURORE

Gjeologjia, Gjeomorfologjia dhe Hidromorfologjia

Gjeologjia

Lumi Vjosa/Aoos ndahet në tre seksione: seksioni i rrjedhës së sipërme i luginës së lumit kullon ofiolitet, depozitimet e flishit, depozitimet e karbonatit dhe të gurit gëlqeror. Seksioni i rrjedhës së sipërme i lumit të Vjosës u ngri gjatë Maksimumit të Fundit të Akullnajave. Në seksionin e rrjedhës së mesme, mes Dragotit dhe Poçemit, lumi rrjedh kryesisht mbi depozitimet e flishit të zonës tektonike jonike. **Seksioni i rrjedhës së poshtme** shtrihet nga Poçemi në Detin Adriatik dhe lumi rrjedh mbi zonën tektonike jonike e depozitimet kuaternare të zonës tektonike të ultësirës para-adriatike, e cila përbëhet kryesisht nga zhavorr, rërë, baltë dhe argjilë (Skrame, 2020).

Gjeomorfologjia

Ndonëse shtresa e akullit në Luginën e Vjosës ishte e kufizuar gjatë periudhave të akullnajave, ndikimi i saj në karakteristikat hidromorfologjike të lumit Vjosa ishte shumë i theksuar. Ndikimi pasqyrohet në dy procese të ndryshme: prerja e qartë e lumit në depozitime lumore, duke treguar se rezerva historike sedimentare ishte më e lartë se sot, dhe siç tregohet në seksionet e tjera të lumit, ato rezerva sedimentare janë aktualisht të barabarta, madje edhe më të lartë krahasuar me ato gjatë epokës së akullnajave apo më herët. Seksioni i Poçemit dhe Përmetit kanë profil linear gjatësor, gjë që më tepër tregon transportin e qëndrueshëm të rezervave sedimentare se sa lidhjen e rrjedhës së poshtme. Më parë, gjetje të tilla bëheshin të ditura vetëm nga eksperimente laboratorike. Lugina e Vjosës dhe vetë lumi janë pikë ndërkombëtare referimi për nga karakterizimi hidromorfologjik i lumenjve të Ballkanit dhe nga proceset e formimit të peizazhit (Hauer, 2021).

Hidromorfologjia

Korridori i luginës së lumit të Vjosës dhe i habitateve përreth tij kanë vlerë të lartë mbrojtjeje. Vazhdimësia gjatësore e rrjedhës së ujit (siç quhet ndryshe "regjimi natyror i rrjedhës") lidhet me transportin e paprekur të sedimenteve. Dinamika e paprekur e lumit përgjatë të gjithë gjatësisë së tij gjeneron një heterogjenitet të lartë hapësinoro-kohor, ndryshim të vazhdueshëm habitati dhe një gamë të gjerë trashëgimie biotike. Dinamika e paprekur e lumit në pellgun ujëmbledhës të Vjosës dhe dinamika e mbrojtur lumore përbëjnë bazat e lidhjes specifike të biotës së mirëpërshtatur me diversitetin e lartë alfa, beta dhe gama dhe me statusin e shkëlqyer të mbrojtjes. Karakteristika të tilla natyrore lumenjsh të mëdhenj nuk gjenden më në asnjë vend të Evropës Qendrore (Scheimer, 2020).

Biodiversiteti i Luginës së Vjosës

Vlera e biodiversitetit të luginës së lumit të Vjosës pasqyrohet nga diversiteti i habitateve dhe pasuria e moria e specieve të vlerësuara sipas kriterëve dhe instrumenteve të ndryshme të vlerësimit (të tilla si listat e kuqe kombëtare të specieve të rrezikuara, shtojcat e Konventës së Bernës, Shtojcat e Direktivave për Habitatet dhe Shpendët e BE-së, listat e kuqe globale të IUCN-së).

Habitatet/Ekosistemet

Studimi paraprak i seksionit të mesëm të Lumit të Vjosës zbuloi se ka tetë lloje habitatesh lumore me rëndësi mbrojtjeje sipas BE-së: 3220 Lumenj aplinë dhe bimësi barishtore përgjatë brigjeve të tyre, 3250 lumenj mesdhetarë me rrjedhë konstante me *Glaucum flavum* (lulëkuqe e verdhë), 3230 lumenj aplinë dhe bimësi drusore

me *Myricaria germanica* (tamarisk gjerman), 3240 lumenj aplinë me bimësi drusore me *Salix eleagans*, 92D0 Korridoret bregdetare jugore dhe gëmushat (*Nerio-Tamaricetea dhe Securinegion tinctoriae*), 6210 kullota gjysmë natyrore të thata dhe sipërfaqe toke me shkurre në nënshtresa gëlqerore, 91E0 pyje lyshtërore me *Alnus glutinosa dhe Fraxinus excelsior* (Alno-Padion. Alnion incanae. Salicion albae), 92C0 Pyje *Platanus orientalis dhe Liquidambar orientalis* (*Platanion orientalis*); Egger et al., 2019; Meulenbroek et al., 2021).

Shqipëria është tashmë në fazën e "transpozimit" (apo integrimin) të legjislacionit të BE-së në legjislacionin kombëtar. Llojet e rralla dhe karakteristike në nivel evropian të habitateve të përmendura më sipër, përcaktohen edhe si zona me rëndësi të veçantë mbrojtjeje në zbatim të së drejtës së tyre. Territori i Shqipërisë përfaqëson vetëm 0,00064% të territorit të BE-së, megjithatë disa prej llojeve të mësipërme të habitateve që gjenden përgjatë lumit të Vjosës mbulojnë jo më pak se 1,8% (HT 3250) ose 1,2% (HT 3230) të këtij lloji të veçantë habitati në territorin e BE-së. Habitatet e Luginës së Vjosës janë me **rëndësi shumë madhe evropiane** sa i përket mbrojtjes së natyrës sipas kritereve të renditura në direktivën për habitatet.

Speciet

Deri më sot, në lumin e Vjosës, janë dokumentuar në total 1175 specie (Meulenbroek et al. 2021, Schiemer et al. 2018, Egger et al. 2019 dhe Fontes et al. 2019), duke përfshirë 516 artropodë, 157 shpend, 37 peshq, 24 gjitarë, 109 molusqe, 19 zvarranikë, 9 amfibë, 299 bimë vaskulare, dhe 5 bimë jovaskulare (Figura 2).




Figura 1. Shpërndarja e specieve e të gjitha grupeve taksonomike të dokumentuara përgjatë lumit të Vjosës.

Nga të gjitha 1175 speciet e dokumentuara deri më tani, 39 prej tyre janë në Listat e Kuqe të IUCN-së dhe 119 në Listën e Kuqe të Shqipërisë. Jo më pak se 15 specie të Listave të Kuqe të IUCN-së dhe 74 specie të

Listës së Kuqe Shqiptare klasifikohen si "në rrezik" (RRKR – të rrezikuara në mënyrë kritike, RR - të rrezikuara, VU - vulnerabël).

Sipas Listës së Kuqe të IUCN-ës, speciet e kërcënuara në nivel global janë: 1 amfib (*Pelophylax shqiperus* - EN), 2 Shpend (*Neophron percnopterus* - RR dhe *Streptopelia turtur* - VU), 7 peshq (4 RRKR (*Acipenser naccarii*, *Acipenser stellatus*, *Acipenser sturio*, *Aphanius iberus*), 2 RR (*Anguilla anguilla*, *Gobio scadarensis*) dhe 1 VU (*Oxynoemacheilus pindus*), 1 gjitar (*Myotis capaccinii* - VU), 2 molusqe (*Unio crassus* - RR, *Vertigo moulinsiana* - VU) dhe 2 bimë vaskulare (*Aesculus hippocastanum*, *Galanthus reginae-olgae*, të dyja VU). Prania e specieve të mësipërme të rrezikuara në Listën e Kuqe të IUCN-së tregon **rëndësinë ndërkombëtare** të Lumit të Vjosës për sa i përket **mbrojtjes së natyrës**.

Në shtojcën 1 - 3 të Konventës së Bernës renditen 148 specie në total, ku 41 janë në shtojcën e direktivës për shpendët dhe 78 në direktivën për habitatet. Në shtojcën I të Direktivës për Shpendët renditen 36 specie zogjsh dhe në Shtojcën II të Direktivës për Habitatet renditen 1 amfib, 3 artropodë, 12 peshq, 10 gjitarë, 3 molusqe dhe 5 zvarranikë. Dy lloje peshqish dhe 2 gjitarë që gjenden në Luginën e Vjosës dhe që renditen në Shtojcën II të Direktivës për Habitatet konsiderohen si specie me përparësi dhe me rëndësi shumë të madhe mbrojtjeje në nivel BE-je. Ekzistenca e një numri kaq të madh specimesh të rrezikuara, së bashku me vlerat e jashtëzakonshme dhe me rritjen e llojeve tejet të rrezikuara dhe të rralla të habitateve të Luginës së Vjosës, tregojnë **rëndësinë evropiane** të **mbrojtjes së natyrës** së zonës. Shtetet anëtare të BE-së janë të detyruar të garantojnë statusin e favorshëm të mbrojtjes për këto specie, si dhe të përcaktojnë zonat e mbrojtura dhe/ose vendet e Natura 2000 për popullimet e tyre.

Në nivel kombëtar, 5 artropodë konsiderohen si specie vulnerabël (VU); grupet e tjera taksonomike të renditura në Listën Kombëtare të Kuqe përfshijnë 30 shpend (6 RRKR, 6 RR, 18 VU), 6 peshq (5 RR, 1 VU), 6 gjitarë (2 RR, 4 VU), 3 zvarranikë (RRKR) dhe 24 bimë vaskulare (8 RRKR, 5 RR, 11 VU). Në Luginën e Vjosës gjenden habitatet më të mëdha kombëtare të disa specieve të caktuara ose të atyre që nuk gjenden në asnjë vend tjetër në Shqipëri, ndërsa studimet e bëra deri më tani kanë zbuluar edhe disa specie të tjera të reja për shkencën. Të gjitha këto së bashku konfirmojnë rëndësinë kombëtare të Luginës së Vjosës sa i përket **mbrojtjes së natyrës** dhe theksojnë vlerën e lartë të mbrojtjes së Lumit të Vjosës **krahasuar me lumenj të ngjashëm në Shqipëri**.

Karakteristikat socio-ekonomike

Popullsia totale e Luginës së Vjosës përllëgaritet të jetë rreth 130 000 banorë, e cila përbën 4,6% të popullsisë totale të Shqipërisë. Veprimtaritë kryesore socio-ekonomike të kësaj zone janë bujqësia, blegtoria dhe turizmi. Gjatë 30 viteve të fundit, zona e lumit të Vjosës është ndeshur me shpopullim të madh. Në njëzet vitet e fundit, vetëm në rajonin e Gjirokastrës (që përfshin bashkitë Përmet, Këlcyrë, Tepelenë, Memaliaj, Gjirokastrë, Libohovë, Dropull), popullsia është zvogëluar me pothuajse gjysmën e saj (47%)(2001-2020) (INSTAT). Rënia drastike e popullsisë së këtyre zonave ka çuar në rënie të konsiderueshme të veprimtarive dhe industrive ekonomike në Luginën e Vjosës.

Trashëgimia dhe vlerat kulturore të zonës

Lugina e Vjosës ka pasuri të jashtëzakonshme monumentesh kulturore të të gjitha periudhave dhe llojeve, duke përfshirë Gjirokastrën e cila është listën e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s. Monumentet kulturore të të gjitha periudhave dhe llojeve përfshijnë 7 monumente në rajonin e Fierit, 26 monumente në rajonin e Vlorës, 10 monumente në zonën e Korçës dhe 536 monumente në zonën e Gjirokastrës. Nga këto monumente, 3 janë qendra historike (Gjirokastra, Përmeti dhe Bënja) dhe 3 janë parqe arkeologjike (Antigonea, Amantia dhe Bylisi). Si shembull të monumenteve të jashtëzakonshme kulturore mund të përmendim monumentet fetare myslimane, qytetet e lashta, duke përfshirë fortesat dhe kullat e tyre të

mbrojtjes, kishat ortodokse dhe manastiret, shtëpitë dhe fshatrat e rrënuara, urat, ujësjellësit, pusët e ujit dhe sistemet ujore, banjat termike romake dhe shpellat parahistorike.

Baseni më i madh i Vjosës në Shqipërinë e Jugut është shtëpia e një prej zhanreve më të famshme muzikore popullore në botë, siç është Isopolifonia Popullore Shqiptare, e cila u shpall dhe u regjistrua zyrtarisht në vitin 2005 në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit të UNESCO-s.

Kërcënimet dhe presionet ndaj zonës

Regjimi i ujit, sasia dhe cilësia e tij janë vendimtare për mirëmbajtjen e ekosistemit ujor të paprekur dhe unik të Lumit të Vjosës.

Urbanizimi, zhvillimi industrial, bujqësia, prodhimi i energjisë, ekzistenca e pikave të nxehta dhe shkarkimi i ujërave të zeza urbane dhe rurale në të dy anët e Lumit të Vjosës në rrethinat e Përmetit, Këlcyrës, Tepelenës, Gjirokastrës, Selenicës, Memaliajt, pjesërisht Fierit dhe Vlorës, konsiderohen si burimet kryesore të ndotjes. Gjithashtu, pellgu ujëmbledhës është pjesërisht i shpyllëzuar dhe zonat buferike shpesh kultivohen si toka të punueshme. Lumi i Vjosës dhe degët e tij përdoren si kanalizime për shkarkimin e ujërave të zeza nga bashkitë dhe industria. Burimet e tjera të ndotjes dhe presioneve të lumit përfshijnë hedhjen e mbetjeve bashkiake, shkarkimet e ujërave të zeza dhe hedhjet e mbetjeve industriale.

Përveç ndotjes, ndikimet e drejtpërdrejta mbi regjimin e ujit vijnë nga zhvillimi i paqëndrueshëm, veprimtaritë industriale, përfshirë industrinë e turizmit, bujqësinë dhe blegtorinë, punimet minerare të gërmimit të zhavorrit në shtratin e lumit dhe nxjerrja e ujit për ujitje dhe për përdorim si ujë i pijshëm (mbushja e shisheve). Habitatet natyrore rrezikohen nga veprimtaritë pyjore, të tilla si prerja e pakontrolluar dhe mbledhja e druve të zjarrit. Erozioni i rëndë i brigjeve lumore, veçanërisht në seksionin që përfshin Tepelenën deri në Vlorë dhe përmytja e pjesës së poshtme të rrjedhës së lumit, konsiderohen si probleme natyrore; gjithashtu, përmytjet e ndotura ndikojnë negativisht edhe tek toka bujqësore. Ndonëse në Shqipëri gjuetia është e ndaluar me ligj, niveli i gjuetisë në këtë zonë është ende i lartë.

Uji i lumit të disa prej degëve përdoret për prodhimin e energjisë, si p.sh. në Langaricë, Drinosi, Kardhiqi dhe Shushica, pa marrë parasysh ndikimin kumulativ mbi cilësinë dhe sasinë e ujit. Sidoqoftë, kërcënimi më i madh i mundshëm ndaj kushteve hidrologjike, morfologjike dhe ekologjike të lumit të Vjosës vjen nga planet për ndërtimin e disa hidrocentraleve.

III. OBJEKTIVAT, STANDARDET DHE ZONIMI I PARKUT KOMBËTAR

Përkufizimi i qëllimit të mbrojtjes dhe objektivat e mbrojtjes

Statusi i zonës së mbrojtur të propozuar dhe arsytimi i kategorisë së zonës së mbrojtur në përputhje me standardet

Zona e lumit të Vjosës dhe degët e saj, rrjedha e të cilave shtrihet brenda territorit shqiptar, është propozuar të shpallet si Park Kombëtar, pra Parku i Parë Evropian i Lumit të Egër.

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e natyrës (Ligji 81/2017) parashikon katër kushte që duhet të përmbushë zona që propozohet për t'u shpallur Park Kombëtar; zona duhet të ketë sipërfaqe të konsiderueshme (jo më pak se 1000 hektarë), duhet të ketë vlera unike natyrore dhe ndërkombëtare, sistemet e administrimit në fuqi duhet të mbrojnë ekosistemet dhe speciet e të promovojnë arsimin dhe rekreacionin, si dhe duhet të krijojë rregullore për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Sipërfaqja e Parkut të Propozuar Kombëtar

Zona që do të përfshihet në Parkun Kombëtar përbëhet nga zona qendrore (bazë) (ZONA 1) prej 263 km² dhe zona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm e rekreacionit (ZONA 2) prej 203 km².

Sipërfaqja totale e Parkut Kombëtar të Propozuar të Lumit të Egër Vjosa është **466 km²**.

Zona buferike e Parkut Kombëtar në ZONËN 3 është **874 km²**.

Vlerat unike natyrore dhe ndërkombëtare

Vlerat unike natyrore, gjeomorfologjike, gjeologjike, atraktive dhe kulturore të Luginës së Vjosës janë paraqitur shkurtimisht në kapitujt e mësipërm. Ato pasqyrojnë vlerat e jashtëzakonshme ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare që e dallojnë Lumën e Vjosës nga lumenjtë të ngjashëm në Shqipëri edhe në një kontekst më të gjerë evropian.

Objektivi kryesor i menaxhimit (mbrojtja e ekosistemeve dhe e specieve dhe promovimi i edukimit dhe rekreacionit)

Standardet ndërkombëtare për zonat e mbrojtura të zbatuara në legjislacionin shqiptar rekomandojnë shpalljen si zonë të mbrojtur Kategoria II "Park Kombëtar", sipas Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN), zonat me biodiversitet të ruajtur dhe të karakterizuara kryesisht nga procese të pandryshuara ekologjike.

Habitatet përgjatë Lumit të Vjosës dhe degëve të saj formojnë një ekosistem funksionues natyror mjaftueshëm të madh për zbutjen e çrregullsive të jashtme të zonave të tjera të ndryshuara që gjenden ngjitur me korridorin e lumit dhe përgjatë tij, pa cenuar ndjeshëm proceset natyrore hidrologjike. Megjithatë, ekosistemi është jashtëzakonisht i brishtë dhe i ndjeshëm, ndaj dhe mund të ndryshohet dramatikisht nga çfarëdolloj ndryshimi që mund t'i bëhet regjimit të ujit në rrjedhën e sipërme apo të poshtme.

Vjosa përfaqëson një ekosistem natyror dhe jo një peizazh kulturor të bërë nga dora e njeriut. Qëllimi i mbrojtjes së zonave "Peizazhi i Mbrojtur", në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe të legjislacionit në Shqipëri për zonat e mbrojtura, nuk është ruajtja e procesit të paprekur ekologjik së bashku me biodiversitetin e tij, por mbrojtja e sistemeve të modifikuara natyrore që kanë çuar vetëm në rritje të rripave/brigjeve të përmytjeve përgjatë të Lumit të Vjosës.

Objektivat e menaxhimit dhe standardet për Peizazhin e Mbrojtur në Shqipëri krijojnë hapësira për një "projekt" që nuk do të siguronte mbrojtje afatgjatë dhe efektive kundër modifikimit të regjimit hidrologjik të Lumit të Vjosës dhe degëve të tij.

Objektivat e propozuara të menaxhimit të Parkut të Ardhshëm Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa

Objektivi kryesor i Parkut të Ardhshëm Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa është mbrojtja e biodiversitetit natyror, së bashku me strukturën themelore ekologjike dhe proceset mbështetëse mjedisore, si dhe promovimi i veprimtarive rekreative e edukative të përputhshme me konceptin e "turizmit të gjelbër" dhe promovimi i zhvillimit të komuniteteve lokale në sipërfaqen e mbuluar nga Lumi i Vjosës.

Objektiva të tjerë:

- Menaxhimi i zonës në mënyrë të tillë që shembujt përfaqësues të rajoneve fiziografike, komuniteteve biologjike, burimeve gjenetike dhe proceseve të paprekura natyrore të mbahen dhe të ruhen në gjendje sa më natyrore që të jetë e mundur;
- Mbajtja e popullimeve dhe grumbullimeve funksionale ekologjike e specieve vendase në nivelin e mjaftueshëm të dendësisë me qëllim që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe e qëndrësës afatgjatë të ekosistemit;
- Kontributi specifik në mbrojtjen e specieve universale, proceseve ekologjike dhe rrugëve të migrimit;
- Ruajtja e hapësirave të përdorimit për vizitorët për qëllime frymëzuese, arsimore, kulturore dhe rekreative aq sa të mos shkaktojnë degradim të konsiderueshëm biologjik ose ekologjik të burimeve natyrore;
- Adresimi i nevojave të komuniteteve lokale, duke përfshirë përdorimin e burimeve të jetesës, kur nuk cenohet objektivi kryesor i menaxhimit;
- Kontributi në ekonominë lokale përmes turizmit.

Kufijtë, zonimi, zona buferike dhe përdorimi i burimeve natyrore

Për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa propozohet koncepti i mëposhtëm:

- zona qendrore (ZONE 1),
- zona e rekreacionit, përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm (ZONE 2) dhe
- zona buferike e Parkut Kombëtar (ZONA 3).



Harta e kufijve dhe zonave të propozuara për Parkun e Ardhshëm Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa

- ZONA E PARKUT KOMBËTAR 1 – e kuqe: ZONA QENDRORE

Zona qendrore përfshin vetëm sipërfaqen e ngushtë të shtratit të lumit, me pjesë të përmbytura rregullisht gjatë sezonit të përmbetjeve në zonat më të ulëta të luginës. Kjo zonë (e identifikuar si ZONA 1; me ngjyrë të kuqe) ka për qëllim mbrojtjen e plotë të biodiversitetit dhe garantimin e një zone të paprekur natyrore. Gjendja aktuale natyrore e ZONËS 1 nuk përfshin asnjë infrastrukturë, ndërtesë apo tokë për bujqësi (tokë bujqësore) apo tokë për kullotë. Siç mund të paramendohet dhe kuptohet, brenda kësaj zone bazë nuk ka vendbanime njerëzish/shtëpi individuale. Veprimtaritë rekreative me bazë ujërat e Lumit të Vjosës dhe të degëve e tij janë të lejueshme dhe duhet të nxiten.

Regjimet e mbrojtjes së Nivelit A dhe Nivelit B (siç parashikohen në Ligjin 81/2017) brenda kësaj zone bazë të Parkut Kombëtar, mund të përcaktohen në fazën e planifikimit të detajuar.

- ZONA E PARKUT KOMBËTAR 2 – e verdhë: ZONA E REKREACIONIT, PËRDORIMIT TRADICIONAL DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Dy nënzona duhet të përcaktohen më vonë në fazën e planifikimit të detajuar të Parkut Kombëtar: zona e rekreacionit, e përdorimit tradicional dhe e zhvillimit të qëndrueshëm. Aktualisht, të dyja këto nënzona nuk janë ende të përcaktuara por paraqiten së bashku si ZONE 2 (me ngjyrë të verdhë).

Nënzona e rekreacionit dhe e përdorimit tradicional ka kryesisht për qëllim mbrojtjen e biodiversitetit duke garantuar nivelin e ulët të cenimit të sipërfaqes natyrore me aktivitete tradicionale dhe ekoturistike. s. Kjo zonë përfshin sipërfaqe kryesisht të rrafshëta në zonën e parë të përmbytjes, e cila nuk përmbytet çdo vit. Zona dominohet nga kullota dhe sipërfaqe të caktuara me toka bujqësore, si dhe përfshin disa zona të izoluar banimi dhe bujqësore në zonën e parë të përmbytjes.

Në këtë zonë (që nuk përmbytet çdo vit), mund të bëhen aktivitete turistike dhe argëtimi që nuk e ndryshojnë zonën pas miratimit të institucioneve përkatëse. Kjo zonë shërben edhe si bazë mbështetëse infrastrukturore për aktivitetet rekreative të ZONËS 1 (p.sh. pika e aksesit për sportet e ujit si rafting, kanoe etj.), e cila përfshin ngritjen e objekteve të përkohshme për turizmin dhe rekreacionin.

Zona e zhvillimit të qëndrueshëm ka për qëllim mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive socio-ekonomike dhe turistike, duke përfshirë infrastrukturën për banorët dhe bizneset vendase. Në këtë zonë përfshihen sipërfaqe me dendësi të lartë populimi, të cilat kultivohen intensivisht.

Standardet ndërkombëtare (IUCN) për zonat e mbrojtura kërkojnë zbatimin e objektivit kryesor të menaxhimit të zonave të mbrojtura në mbi 75% të territorit të zonës së mbrojtur. Ky standard do të arrihet me identifikimin e zonave me regjime specifike menaxhimi në ZONËN 2, të cilat do t'i shtohen ZONËS 1.

ZONA 1, në të cilën është planifikuar tashmë objektivi kryesor i menaxhimit, mbulon 56% të Parkut të Ardhshëm Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa.

- ZONA BUFERIKE E PARKUT KOMBËTAR/ZONA 3 – ngjyrë vjollcë

ZONA 3 duhet të formojë zonën buferike të Parkut Kombëtar. Ajo gjendet në zonën e parë të përmytjeve (ZONE 3 – ngjyrë vjollcë).

Skaji i jashtëm i ZONËS së verdhë 2, përfaqëson edhe **kufijtë** e jashtëm të propozuar të Parkut Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (466 km²). ZONA 3 vjollcë është zona buferike e Parkut Kombëtar (874 km²).

Përdorimi i rregulluar i burimeve natyrore

Veprimtaritë ekonomike, sociale, turistike, studimet shkencore dhe të gjitha aktivitetet e tjera të parashikuara në Planin e Menaxhimit që nuk ndalohen shprehimisht me Ligjin 81/2017 **mund të kryhen në Parkun e Propozuar Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa.**

Aktivitetet e **lejuara në parkun e propozuar kombëtar pas lëshimit të lejes** nga autoritet kompetente përfshijnë:

- Çfarëdolloj veprimtarie që bëhet në përputhje me planin e menaxhimit ose me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit;
- Monitorimin e kushteve mjedisore, të ekosistemit, habitateve dhe specieve të florës dhe faunës;
- Studimet kërkimore shkencore, duke përfshirë ato të fushës së trashëgimisë kulturore;
- Ndërtime të përkohshme të lehta turistike, sezonale dhe që nuk dëmtojnë mjedisin.

Propozimi për ndalimin/rregullimin e veprimtarive në Parkun Kombëtar

Ndalimet që do të zbatohen brenda të **gjithë Parkut Kombëtar:**

- Gjuetia (Ligji 81/2017);
- Futja e specieve që nuk janë vendase;
- Shumimi ose futja intensive e kafshëve të gjuetisë, me përjashtim të mbrojtjes përmes shumimit;
- Pyllëzimi në monokultura;
- Neutralizimi i mbetjeve;
- Ndezja e zjarreve jashtë disa vendeve dhe zonave të caktuara;
- Ndërtimi i autostradave, kanaleve lundruese dhe zonave urbane;
- Drejtimi i automjeteve jashtë rrugëve dhe zonave të përcaktuara.

Drafti dhe lista paraprake e ndalimeve - **ZONE 1**

- Prerja e pemëve dhe e shkurreve;
- Punimet e ndërtimit të asnjë lloji;
- Shfrytëzimi i tokës përmes çfarëdolloj teknologjie, mjeti apo metode që shkakton ndryshime themelore të biodiversitetit, strukturës së ekosistemit dhe funksioneve ose shkakton dëme të pakthyeshme të sipërfaqes së tokës;
- Ndërtimi i rrugëve, linjave elektrike dhe sistemeve të naftës dhe gazit në distanca të gjata;
- Nxjerrja e mineraleve;
- Kullotat, lëvizja e kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i staneve për to.
- Përdorimi i kimikateve dhe plehrave kimikë;
- Lëvizja e çfarëdolloj automjeti, përveç automjeteve të Autoritetit për Mbrojtjen e Rezervave dhe ato të shërbimeve të zjarrit dhe shpëtimit;
- Ndërtimi i objekteve të përhershme të rekreacioni, argëtimit dhe sportit;
- Lundrimi me barka, kanoe apo mjete të tjera lëvizjeje; përveç se në zona të përcaktuara të identifikuara në planin e menaxhimit;
- Veprimtaritë masive të sporteve dhe turistike jashtë vendeve të përcaktuara;
- Organizimi i garave me automjete motorike/barka;
- Larja dhe spërkatja e kimikateve në rrugë.

Drafti dhe lista provizore e ndalimeve - **ZONE 2**

- Ndryshimi i gjendjes natyrore të trupave ujorë dhe ligatinave;
- Hedhja e kimikateve;
- Mbledhja e bimëve, mineraleve, zbulimeve paleontologjie dhe gurëve;
- Ndërtimi dhe operimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe sigurie.
- Ngritja e standave, vendosja e shenjave, reklamave, pankartave dhe posterave, pa cenuar ato që japin informacion mbi objektivat e mbrojtjes së zonës;
- Alpinizmi, kampingu dhe ndezja e zjarreve jashtë zonave të caktuara.

IV. PARKU KOMBËTAR – PLANIFIKIMI

Veprimtaritë për krijimin e modelit të drejtimit dhe menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe hartës së rrugës (PKLEV)

Hapat kyçe administrative (faza 1: krijimi i Parkut Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa - PKLEV)

Veprimtaritë:

- 1 Finalizimi i planit
- 2 Ngritja e ekipit të planifikimit
- 3 Vendimi për shpalljen e Parkut Kombëtar
- 4 Konsultimi me palët e interesit I

- 5a Projekt-propozimi teknik për krijimin e Parkut Kombëtar
- 5b Identifikimi i boshllëqeve në bazën e disponueshme të të dhënave
- 5c Studime të përqendruara shtesë
- 6 Miratimi i propozimit teknik për Parkun Kombëtar
- 7 Projekt-deklarata për Parkun Kombëtar
- 8 Konsultimi me palët e interesit II
- 9 Projekt-plani për shpalljen e Parkut Kombëtar
- 10 Konsultimi me palët e interesit III
- 11 Dekreti për shpalljen e Parkut Kombëtar

		MUAI																							
		0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	2	2	2	2	2
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	0	1	2	3	4
A C T I V I T E S	1	■	■	■																					
	2	■	■	■																					
	3	■	■																						
	4				■	■	■																		
	5a							■	■	■	■	■	■	■	■	■	■								
	5b							■	■	■															
	5c								■	■	■	■	■	■	■	■									
	6																	■	■						
	7																			■	■				
	8																				■	■			
	9																						■		
10																							■		
11																								■	

Hapat kyç mbështetës

Veprimtaritë:

A...Krijimi i fondit të trustit për PKLEV

B...Operimi i fondit të trustit për PKLEV

C...Përgatitja e Planit të Menaxhimit të PKLEV

D...Identifikimi i stafit të ardhshëm të PKLEV-së dhe ofrimi i trajnimeve

E...Veprimtaritë mbështetëse për ndërgjegjësimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe trajnimin për aktivitetet e gjelbra/të zhvillimit të qëndrueshëm për komunitetet dhe aktorët lokalë

F...Strategjia për menaxhimin e vizitorëve dhe interpretimin

G...Identifikimi i nevojave për zhvillimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të menaxhimit të PKLEV

H...Përgatitja e propozimeve/projekteve të financimit për operimin e PKLEV (kontraktim i jashtëm), duke përfshirë zyrat në terren të PKLEV-it, pajisjet

		MUAJ																								
		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	mts
A C T I V I T E S	A	■	■	■	■	■	■																			
	B							■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
	C																■	■	■	■	■	■	■	■	■	
	D																					■	■	■	■	
	E							■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	
	F																				■	■	■			
	G																	■	■	■	■	■	■	■	■	
	H																	■	■	■	■	■	■	■	■	